



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË**

**Adresa: Shëtitore "Rilindja" Tel/Fax: ++355 82 242230; ++355 82 242580
Web: www.unkorce.edu.al e-mail: rektorati@unkorce.edu.al**

MIRATOHET:

**REKTORI
Prof.as.dr. GJERGJI MERO**

**FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE HUMANE
PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER PROFESIONAL**

**RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË
CIKLIT TË DYTË**

MASTER PROFESIONAL

"MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË NË BIOLOGJI-KIMI"

ME KOHË TË PLOTË

Viti akademik 2015-2016

PËRGJEGJËS I GRUPIT MËSIMOR KËRKIMOR TË BIOLOGJI-KIMISË

Dr. Arben Gjata

DEKANI

Prof. Dr. Gjergji Pendavinji

1. EMËRTIMI I PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT TË “Masterit Profesional”:

“Master Profesional” “MËSUESI PËR ARSIMIN E MESEM TË LARTE NË BIOLOGJI-KIMI”

2. FORMAT E STUDIMIT

Forma e studimit është me kohë të plotë .
Master i brendshëm (organizuar nga institucioni)
Gjuha e zhvillimit të programit master shqipe

3.PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

1	Kohëzgjatja e programit të studimit në vite akademike	1,5 vite akademike
2	Kohëzgjatja e programit të studimit në javë mësimore	45 javë mësimore
3	Numuri i krediteve	90
4	Orët mësimore në auditor	1121 orë
5	Ngarkesa minimale javore	25 orë

KOMITETI SHKENCOR

Personeli akademik	Grada shkencore apo titulli akademik	Struktura së cilës i përket	Detyra
1.Arben Gjata	Dr.	Departamenti i Infermierisë dhe Grupit mësimor kërkimor i Biologji–Kimisë	Koordinator
2. Gjergji Pendavinji	Prof.dr.	Dekan i Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane	Anëtar
3. Irena Kallço	Prof. Ass. Dr.	Departamenti i Biokimi-Agroushqim	Anëtar
4.Eda Stasa	Dr	Departamenti i Infermierisë dhe Grupit mësimor kërkimor i Biologji–Kimisë	Anëtar

4.OBJEKTIVAT FORMUESE

Qëllimi i programit të studimit

Programi i studimit ka për qëllim:

- Të përgatitë mësime të suksesshëm, me aftësi të thella profesionale në fushën e **Biologji–Kimisë**, cilësi të larta morale dhe shoqërore për t'u kthyer në modele frymëzuese dhe motivuese për nxënësit.
- Të përgatitë mësime të njohuri bazë dhe të avancuara në fushat kryesore të **Biologjisë dhe Kimisë**, të aftësuar me njohuritë kryesore pedagogjike, kulturore dhe metodike për të bërë mësues të mirë profesionistë për të ardhmen.
- Të përgatitë mësime të njohuri si njerëz të aftë për të punuar dhe për të ndihmuar në komunitet.
- Të përgatitë mësime të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e rajonit dhe më gjerë për të ndihmuar në zhvillimin e tyre, rritur cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve.

Programi i studimit suksesin e tij e bazon:

- Në kompetencën dhe eksperiencën e stafit akademik, dhe ndihmes, një staf me një përvojë të gjatë në fushat e **Biologjisë dhe Kimisë**.
- Në eksperiencën akademike prej 44 vjetësh në lëndët dhe modulet e **Biologjisë dhe Kimisë** që ka Universitetit “Fan S. Noli” i Korçës.
- Në infrastrukturën moderne në përgjithësi dhe laboratorët bashkëkohorë të **Biologjisë dhe Kimisë** që janë ngritur për këtë qëllim pranë Fakultetit të Shkencave Naturore dhe Humane.
- Në përvojën e fituar gjatë viteve në zhvillimin e programeve Master i Nivelit të Parë në Mësuesi dhe Master Profesional në Mësuesi.
- Në rezultatet e mira të studentëve të programit **Biologji–Kimi** në ciklit të parë të studimeve në Fakultetit të Shkencave Naturore dhe Humane të Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës.
- Në kërkesën e madhe që ka tregu i rajonit të Korçës për këta specialiste.

Objektivat e përgjithshme të programit të studimit:

Objektiva të përgjithshme që ka ky program studimi, janë:

- T’ju japë të diplomuarve arsimim dhe trajnim të mëtjshëm profesional në fushën e mësime të **Biologji–Kimisë**;

- T'ju krijojë studentëve një pamje të re për arsimin në Shqipëri, në përputhje me përvojën dhe konceptet evropiane;
- Të përpiqet për të realizuar një status të ri të mësuesit në kushtet e reja ekonomiko-shoqërore që janë krijuar;
- Programi do të shtrojë alternativa konkrete për zhvillimin e arsimit në fushën e mësimdhënies së **Biologji–Kimisë** në bazë të strategjisë kombëtare dhe të japë ndihmesën e vet për hedhjen dhe konsolidimin e bazave për një arsim sa më profesionist.
- Objektivi final i programit është që të përgatitë specialistë të zotë në fushën e mësimdhënies së **Biologji–Kimisë** që të thithen nga tregu i punës, qoftë në sektorin arsimor shtetëror e privat, ashtu edhe në sektorin privat industrial e ushqimor si specialistë trajnues i problemeve **kimike e biologjike** që shtrohen me forcë dhe janë të detyrueshme nga standartet e B.E dhe Republikës së Shqipërisë.

Objektiva formuese të disiplinave:

Objektivat formuese të disiplinave që ka ky program studimi janë:

- Pajisja e studentëve me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehje praktike për arritjen e standardeve të larta në mësimdhënie në fushën e **Biologji–Kimisë**, duke zbatuar teoritë dhe praktikën e arsimit në lidhje me karakteristikat e grup moshave, përparësitë e arsimit në vendin tonë dhe rolin e mësuesit si profesionist në një kontekst social në ndryshim të vazhdueshëm;
- Pajisja e studentëve me njohuri bazë të kërkimit. Nëpërmjet lëndës së Kërkimit Shkencor do të pajisen me metodologjitë e kërkimit dhe të hulumtimit shkencor, të metodave kryesore në kërkimin biologjik, kimik dhe kërkimin në fushën e edukimit, ç'ka do të bëjë që ata të jenë në gjendje të zbatojnë kërkimin shkencor në klasat ku do të zhvillojnë mësim.
- Pajisja e studentëve me njohuri për mënyrën e mësimdhënies të kimisë në shkollë me larmshmërinë e formave në klasë, laborator dhe jashtë shkolle.
- Pajisja e studentëve me njohuri bazë të planifikimit dhe të mësimdhënies në kimi, format e organizimit të procesit mësimor, metodat e mësimdhënies së biologjisë dhe kimisë, planifikimi vjetor dhe ditor i mësimdhënies, me metodat bashkëpunuese të mesimdhënies, diskutimit, debateve, vrojtimit, eksperimentimit si dhe punëve praktike.
- Zhvillimi i aftësive praktike dhe profesionale të studentëve në teknikat e laboratorit dhe eksperimentit në biologji dhe kimi duke përdorur metoda që sigurojnë një përvetësim aktiv të njohurive të marra në teori aftësive komunikuese në seminare dhe në praktikën mësimore të vëzhguar në shkollë.

- Paraqitja dhe përpunimi i metodave dhe mënyrave të ndryshme të mësimdhënies për një mësim aktiv dhe gjithëpërfshirës.
- Aftësimi i studentëve për zgjidhjen e situatave problemore në arsim në kontekste të ndryshme.
- Sigurimi i një konteksti akademik për diskutimin e çështjeve që lidhen me mësimdhënien e lëndëve, me synim zhvillimin e perspektivës teorike të studentëve dhe edukimin e kompetencave specifike për secilën lëndë. Njohja me zhvillimet më të fundit në fushën e mësimdhënies së këtyre lëndëve dhe aftësimin e tyre për komunikimin dhe teknologjitë e informacionit bashkëkohor.
- Realizimi i përgatitjes profesionale të studentëve duke u përqëndruar në çështje të tilla si testimi, menaxhimi, strategjitë e të nxënit, punë kërkimore dhe të mësuarit për gjatë gjithë jetës.
- Një objektiv tjetër i rëndësishëm është që t’ju jepet studentëve një përvojë profesionale në njohjen e institucionit arsimor për të cilin ata përgatiten, për mënyrën e komunikimit dhe menaxhimit të klasës, në didaktikën e mësimdhënies, vlerësimin të nxënësve etj. Këtij qëllimi i shërben më së miri edhe ngritja pranë Fakultetit tonë e Qendrës së Ekselencës, e cila do të jetë një mbështetje e fuqishme për mësimdhënësit e ardhshëm;
- Një objektiv tjetër është pajisja e studentëve me njohuri metodologjike të Edukimit Shëndetësor. Kjo synon t’ju japë studentëve njohuri mbi konceptet bazë të shëndetit si dhe faktorët përcaktues të tij.
- Ruajtja e vlerave kulturore kombëtare, standardeve mjedisore biologjike dhe kimike, biodiversitetit, dhe interesave kombëtare.

Objektivat për aftësimin praktik të studentëve janë:

- Të sigurojë cilësinë e mësimdhënies nga mësuesit e rinj të biologjisë dhe kimisë dhe performancë të lartë të profesionit të mësuesit nëpërmjet praktikës profesionale në shkollat më të mira 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit nën drejtimin e mësuesve “Mentor” të biologjisë dhe kimisë dhe pedagogëve të Fakultetit, me qëllim vënien në praktike të teorisë, të metodave dhe teknikave të mësimdhënies.
- Të sigurojë zhvillimin e kapaciteteve të mësuesve të ardhshëm për një përshtatje më të mirë ndaj ndryshimeve të kurrikulës, mësimdhënies si dhe komunikimit dhe normave të etikës e të sjelljes së mësuesit.
- Të sigurojë përvetësimin e mëtejshëm të njohurive teoriko-profesionale, dhe të aftësive e shprehive praktike në fushën e **eksperimentimeve laboratorike të Biologjisë dhe Kimisë** duke dhënë njëkohesisht dhe eksperiencën e përfutur gjatë studimeve në këtë program masteri.

- Në fund të praktikës mësimore, studentët vlerësohen nga mësuesit “Mentor” të biologjisë dhe kimisë dhe nga drejtoria e shkollës përkatëse, ku kanë zhvilluar praktikën mësimore.

Objektivat për hartimin e tezës së diplomës:

- Në përfundim të studimeve çdo student paraqet një punë kërkimore në formën e një teze diplome me 10 kredite përmes së cilës synohet që studentit të zhvillojë aftësitë e konceptimit, të analizës dhe të interpretimit në fushën e metodologjisë mësimdhënies së biologjisë dhe kimisë, problematikave rajonale në fushën biologjike dhe kimike, si dhe të shkrimit dhe të paraqitjes së saj.
- Të njihet me metodologji të ndryshme kërkimore në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe eksperimental në **Biologji–Kimi** përmes seminarit kërkimor që ka ky program i masterit.
- Zhvillimin e teknikave të kërkimit shkencor dhe eksperimental në fushën e **Biologji–Kimisë** dhe nxjerrjes së informacionit të domosdoshëm në këto fusha duke shfrytëzuar labororet bashkëkohore që ka në dispozicion Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane dhe Fakulteti i Bujqësisë të Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës.
- Zhvillimin e shprehive dhe aftësive të transferueshme të nivelit më të lartë në kërkimin shkencor dhe interpretimin e të dhënave.
- Zhvillimin e shprehive të mendimit kritik, si dhe të vlerësimit të të dhënave dhe informacionit në fushat e **Biologji–Kimisë**, të interesave profesionale të studentëve të lidhura me mësimdhënien në këto fusha.
- Ndërgjegjësimin e studentëve në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të përgjegjësive të tyre personale në përfshirjen në punë të pavarur kërkimore-shkencore, si dhe vlerësimin kritik të informacionit dhe të dhënave dhe konkluzioneve të kërkimit shkencor dhe eksperimental në fushat e **Biologji–Kimisë**.
- Të nxitë e studentët për të kryer punë kërkimore shkencore dhe eksperimentale duke shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni (literaturë bashkëkohore, site interneti, periodikë, manuale didaktike etj) si dhe **laboratorët** e biologjisë dhe kimisë me infrastrukturë bashkëkohore që disponon Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane.

Tipologjitë e temave:

- Studentët marrin një temë kërkimore nën udhëheqjen e njërit prej anëtarëve të stafit akademik me gradë shkencore.
- Temat kërkimore përzgjidhen në përputhje me qëllimin e kësaj kurikule për përgatitjen e mësuesve të Biologji–Kimisë.

- Temat orientohen në kërkimet biologjike dhe kimike në fushën e mësimdhënies, në çështjet programore, kurikulat e veçanta përgatitjen për mësimdhënie, teknikat dhe metodat e mësimdhënies në Biologji–Kimi dhe problematikave rajonale në fushën biologjike e kimike.

PROFILI PROFESIONAL DHE SEKTORËT E PUNËSIMIT RESPEKTIV

Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin

Programi i studimit **Master profesional, “MËSUESI PËR ARSIMIN E MESEM TË LARTE NË BIOLOGJI-KIMI”** ka për qëllim të pajisë studentët me:

- Kompetencë të lartë në zotërimin e disiplinave të **Biologji–Kimi** dhe mësimdhënies;
- Kompetencë për të dhënë mësim në kontekste të shumëllojshme, në arsimin publik dhe jopublik, me nxënësit për qëllime specifike;
- Aftësi për përdorimin e teknologjive të mësimdhënies, e teknikave të laboratorit të biologjisë e kimisë dhe e teknikave të komunikimit;
- Aftësi për të reflektuar në mënyrë kritike për praktikën e profesionit dhe për t’u përfshirë në punë kërkimore në fushën e mësimdhënies së biologjisë dhe kimisë.

Mundësitë për punësim

- I diplomuari me formim të tillë mund të punojë si mësues biologjie dhe kimie në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme publike dhe jopublike;
- I diplomuari me formim të tillë mund të punojë si specialist pranë drejtorive arsimore rajonale Institucionet e administrates publike qe lidhen me specialitetin e **Biologjisë dhe Kimisë** disa prej të cilave e kanë dhe kriter ligjor këtë lloj specialiteti të kudrit.
- I diplomuari me formim të tillë mund të punojë në qendrat e kualifikimit të subjekteve private industriale dhe ushqimore si specialist dhe trajnues i probelematikave **kimike e biologjike** trajnime që janë të detyrueshme nga ligjet dhe standartet si të B.E dhe të Republikës së Shqipërisë.
- I diplomuari me formim të tillë mund të punojë në OJQ si specialist dhe trajnues i probelematikave **kimike e biologjike**.

5.STRUKTURA AKADEMIKE PËRGJEGJËSE DHE STRUKTURAT E TJERA BASHKËPUNUESE

Fakulteti apo një strukturë tjetër mësimore e kërkimore	Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.
Struktura të tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione	Ministra e Arsimit dhe Shkencës.

të tjera të arsimit të lartë	Drejtoria Arsimore Rajonale, Korçë. Fakulteti i Edukimit, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë. Fakulteti i Bujqesise, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.
Institucione të huaja të arsimit të lartë	
Subjektë të tjera publike apo private	Subjekte publike e private në fushën e arsimit që veprojnë në qarkun e Korçës, Shqipëri. Subjekteve private industriale dhe ushqimore që veprojnë në qarkun e Korçës, Shqipëri. OJQ që veprojnë në qarkun e Korçës, Shqipëri.

6.STRUKTURA E PLANIT MËSIMOR PËR VITIN AKADEMIK 2014-2015

Tipi i veprimtarisë	Fushat disiplinore	Kredite	Gjithsej
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm Disiplina A	Bazat kulturore të edukimit	3	11
	Bazat pedagogjike te edukimit a. Metodologjia e përgjithshme e mësimdhënies dhe kurrikulat	4	
	Bazat pedagogjike te edukimit b.Kulturë gjuhe	4	
Veprimtari ne disiplina karakterizuese programit te studimit Disiplina B	Bazat psikologjike të edukimit a.Zhvillimi dhe të nxënët	4	37
	Bazat psikologjike të edukimit b.Të menduarit kritik në mësimdhënie	3	
	Mësimdhënia dhe të nxënët në Biologji-Kimi a.Metodologji e mësimdhënies së Biologjisë dhe vlerësimi	6	
	Mësimdhënia dhe të nxënët në Biologji-Kimi b.Metodologji e mësimdhënies së Kimisë dhe vlerësimi	6	

	Mësimdhënia dhe të nxënët në Biologji-Kimi c.Teknika e laboratorit dhe eksperimentit në biologji.	3	
	Mësimdhënia dhe të nxënët në Biologji-Kimi d.Teknika e laboratorit dhe eksperimentit në kimi	3	
	Edukimi shëndetësor dhe metodologjia në edukimin shëndetësor a.Edukimi shëndetësor	3	
	Edukimi shëndetësor dhe metodologjia në edukimin shëndetësor b.Metodat e mësimdhënies në Edukimin shëndetësor	6	
	Shëndeti mjedisor	3	
Veprimtari në disiplina të ngjashme ose/dhe integruese, që lidhen me disiplinat karakterizuese Disiplina C	Metodat e kërkimit shkencor a: Metodat e kërkimit në edukim b: Seminar kërkimor (për përgatitjen e mikrotezës)	7	11
	Zhvillimi profesional i mësuesit dhe etika e profesionit	4	
Disiplina me zgjedhje të studentit, ndër disiplinat e ofruara nga institucioni Disiplina D	Menaxhimi i arsimit dhe Legjislacioni i arsimit parauniversitar	3	3
	Teknika e metodave instrumentale të analizave kimike	3	
Njohuri të tjera formuese, si plotësime në gjuhë të huaja, informatikë, prezantuese, stazh apo praktika, etj Disiplina E	Shprehja gjuhësore dhe komunikimi a.Gjuhë angleze për qëllime specifike	3	18
	Shprehja gjuhësore dhe komunikimi b.Teknologjia e komunikimit dhe informacionit në ndihmë të mësimdhënies	5	
	Praktike mësimore e mësimdhënies	10	
Teza e diplomës Disiplina F	Teza	10	10
Shuma			90

Gërmat A - F janë përdorur si simbole për veprimtaritë e ndryshme formuese në bazë të Udhëzimit Nr. 15. Datë 04.04.2008, “Për organizimin e studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”,

A→ Veprimtari formuese në një ose më shumë grupe disiplinash që lidhen me formimin e përgjithshëm (Bazë) për programin e studimit;

B→ Veprimtari formuese në një ose më shumë grupe disiplinash që karakterizojnë përkatësinë e programit të studimit;

C→ Veprimtari formuese në një ose më shumë grupe disiplinash të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese që lidhen kryesisht me formime ndërdisiplinore, etj;

D→ Veprimtari formuese të zgjedhura nga studentët, ndërmjet atyre të ofruara nga institucioni dhe koherente me programin e studimit, të realizuara këto gjatë viteve akademike të programit të studimit;

E→ Veprimtari formuese të parashikuara më sipër dhe të fokusuara drejt përfitimit të aftësive në gjuhën e huaj, aftësive informatike dhe telematike, komunikuese dhe prezantuese, ose përgjithësisht të aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës, sikurse edhe aktivitete formuese që lidhen me praktikatat profesionale.

F→ veprimtari formuese që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës.

Në programin e studimit parashikohen:

- leksione **Po**
- ushtrime **Po**
- laboratore **Po**

- projekt/detyra **Po**
- seminare **Po**
- praktikë, stazh, etj, **Po**

7.TË DHËNA PËR PERSONELIN AKADEMIK QË MBULON DISIPLINAT E MËSIPËRME

Për realizimin këtij programi studimi do të angazhohet efektiviteti i Grupit mësues kërkues të Biologji-Kimisë pranë departamentit të Infermierisë, pedagogë nga departamente të tjerë të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane, Universiteti “Fan S. Noli” të Korçës, pedagogë nga Fakulteti i Edukimit, Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës, pedagogë nga departamenti Biokimi-Agrorshqim Fakulteti Bujqësisë Universiteti “Fan S. Noli” të Korçës. Të gjithë pedagogët e angazhuar në këtë program janë **me tituj dhe grada shkencore dhe me kohë të plotë punësi**.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet një listë e pedagogëve të parashikuar në procesin e mësimit.

Lista e pedagogëve të parashikuar për mësimit

Personeli akademik (me kohë të plotë ose të pjesshme)	Titulli apo grada shkencore	Institucioni	Departamenti	Lëndët/Modulet përkatëse
Gjergji Pendavinji	Prof. Dr.	F.SH.N.H. U.Korçës	Departamentit Shkencave Sociale	Metodat e kërkimit shkencor a: Metodat e kërkimit në shkencën e edukimit b: Seminar kërkues (për përgatitjen e mikrotezës)
Ali Jashari	Prof. Dr.	F.E. U.Korçës	Departamentit Gjuhë Letërsisë	Bazat psikologjike të edukimit a. Të menduarit kritik në mësimit Bazat pedagogjike të edukimit b. Kulturë gjuhësore
Aleksandra Piluri	Prof. As. Dr.	F.E. U.Korçës	Departamentit të edukimit	Bazat psikologjike të edukimit a. Zhvillimi dhe të nxënës
Irena Kallço	Prof. As. Dr.	F.B. U.Korçës	Departamentit Biokimi-Agrorshqim	Mësimit dhe të nxënës në Biologji-Kimi a. Metodologji e mësimit në Biologjisë dhe vlerësimi c. Teknika e laboratorit dhe eksperimentit në biologji.
Bashkim Jahollari	Prof. As. Dr.	F.E. U.Korçës	Departamentit Historisë e Gjeografisë	Menaxhimi i arsimit dhe Legjislati i arsimit parauniversitar
Eda Stasa	Dr	F.SH.N.H. U.Korçës	Departamentit Infermierisë dhe Grupit mësues	Edukimi shëndetësor dhe metodologjia në edukimin shëndetësor b. Metodat e mësimit në

			kërkimor i Biologji– Kimisë	edukimin shëndetësor Shëndeti mjedisor
Arben Gjata	Dr	F.SH.N.H. U.Korçës	Departamentit Infermierisë dhe Grupit mesimor kërkimor i Biologji– Kimisë	Mësimdhënia dhe të nxënët në Biologji-Kimi d.Teknika e laboratorit dhe eksperimentit në kimi. a.Teknika e metodave instrumentale te analizave kimike
Sulltana Ajçe	Dr.	F.B. U.Korçës	Departamentit Biokimi-Agroushqim	Mësimdhënia dhe të nxënët në Biologji-Kimi b.Metodologjia e mësimdhënies së Kimisë dhe vlerësimi
Magdalini Vampa	Dr.	F.SH.N.H. U.Korçës	Departamentit Shkencave Sociale	Bazat kulturore te edukimit
Donika Dardha	Docente	F.E. U.Korçës	Departamentit te edukimit	Bazat pedagogjike te edukimit a.Metodologjia e përgjithshme e mësimdhënies dhe kurrikulat
Rafaël Prodani	Dr.	F.SH.N.H. U.Korçës	Departamentit Informatikë dhe Fizikë	Shprehja gjuhësore dhe komunikimi b.Teknologjia e komunikimit dhe informacionit në ndihmë të mësimdhënies
Pavlo Cicko	Prof. As. Dr.	F.E. U.Korçës	Departamentit te Gjuhëve të huaja	Zhvillimi profesional i mësuesit dhe etika e profesionit
Lindita Kacani	Dr.	F.E. U.Korçës	Departamentit te Gjuhëve të huaja	Shprehja gjuhësore dhe komunikimi a. Gjuhë angleze për qëllime specifike
Marjela Burda	Docente	F.E. U.Korçës	Departamentit te edukimit	Edukimi shëndetësor

F.SH.N.H - Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane

F.B.-Fakulteti i Bujqësisë

F.E. - Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

U.Korçës – Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.

a, b, c, d. – Modulet e lëndëve

8.PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL ME KOHË TË PLOTË NË

“MËSUESI PËR ARSIMIN E MESEM TË LARTE NË BIOLOGJI-KIMI”

Viti akademik 2015-2016

Nr.	Disiplina apo titulli i veprimtarisë	Tipi i veprim.	Kreditet	Leks.	Sem.	Lab.	Tot.	Simestri	Frekuentimi
1.	Bazat kulturore te edukimit	A	3	24	14	-	38	I	I detyruar
2.	Bazat psikologjike te edukimit								
	a.Zhvillimi dhe të nxënët	A	4	30	20	-	50	I	I detyruar
	b.Të menduarit kritik	A	3	20	20	-	40	I	I detyruar
3.	Bazat pedagogjike te edukimit a.Metodologjia e përgjithshme e mësimdhënies dhe kurrikula	A	4	30	20	-	50	I	I detyruar
4.	Bazat pedagogjike te edukimit b.Kulturë gjuhe	A	4	30	20	-	50	I	I detyruar
5.	Metodat e kërkimit shkencor a: Metodat e kërkimit në edukim b: Seminar kërkimor (për përgatitjen e mikrotezës)	C	7	30	50	-	80	I	I detyruar
6.	Mësimdhënia dhe të nxënët në Biologji-Kimi a.Metodologji e mësimdhënies së Biologjisë dhe vlerësimi	B	6	40	20	20	80	I	I detyruar
7.	Mësimdhënia dhe të nxënët në Biologji-Kimi b.Metodologji e mësimdhënies së Kimisë dhe vlerësimi	B	6	40	20	20	80	II	I detyruar

8.	Mësimdhënia dhe të nxënët në Biologji-Kimi c.Teknika e laboratorit dhe eksperimentit në biologji.	B	3	15	-	20	35	II	I detyruar
9.	Mësimdhënia dhe të nxënët në Biologji-Kimi d.Teknika e laboratorit dhe eksperimentit në kimi	B	3	15	-	20	35	II	I detyruar
10.	Edukimi shëndetësor dhe metodologjia në edukimin shëndetësor a.Edukimi shëndetësor	B	3	30	15	-	45	II	I detyruar
11.	Edukimi shëndetësor dhe metodologjia në edukimin shëndetësor b.Metodat e mësimdhënies në Edukimin shëndetësor	B	6	45	30	-	75	II	I detyruar
12.	Shprehi gjuhësore dhe komunikimi a.Gjuhë angleze për qëllime specifike	E	3	15	15	-	30	II	I detyruar
13.	Shprehi gjuhësore dhe komunikimi b.Teknologjia e komunikimit dhe informacionit në ndihmë të mësimdhënies	E	5	30	30	-	60	II	I detyruar
GJITHSEJ viti i parë			60	394	274	80	748		

Viti II (i dytë)

Nr.	Disiplina apo titulli i veprimtarisë	Tipi i vepr.	Kredi tet	Leks.	Sem.	Lab.	Tot.	Simestr i	Frekuentimi
1	Zhvillimi profesional i mësuesit dhe etika e profesionit	C	4	20	30	-	50	III	I detyruar
2	Shëndeti mjedisor	B	3	25	13	-	38	III	I detyruar
3	Menaxhimi i arsimit dhe legjislacioni i arsimit parauniversitar (zgjidhet nje lende)	D	3	20	10	-	30	III	I detyruar , (Lëndë me zgjedhje)
4.	Teknika e metodave instrumentale te analizave kimike (zgjidhet nje lende)	D	3	20	-	10	30	III	I detyruar , (Lëndë me zgjedhje)
5.	Praktikë shkollore e mesimdhënies	E	10	-	-	-	130	III	I detyruar

6.	Teza e diplomimit	F	10	-	-	-	125	III	
	GJITHSEJ (viti i dytë)		30	65	53/43	0/10	373		

UNIVERSITETI FAN S. NOLLI

8.1 LËNDET DHE MODULET E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Nr.	Lëndet dhe modulet	Tipi i veprimtarisë	Kreditet	Leks.	Sem.	Lab.	Totali	Jashtë auditor.	Simestri	Departamenti
VITI I PARË										
I	Bazat kulturore te edukimit	A	3	24	14	-	38	37	I	Shkencave sociale
	GJITHËSEJ		3	24	14	-	38	37		
II	Bazat psikologjike të edukimit									
	a.Zhvillimi dhe të nxënt	A	4	30	20	-	50	50	I	Departamentit te edukimit
	b.Të menduarit kritik	A	3	20	20	-	40	35	I	Gjuhë-Letërsisë
	GJITHËSEJ		7	50	40	-	90	85		
III	Bazat pedagogjike te edukimit									
	a.Metodologjia e përgjithshme e mësimdhënies dhe kurrikulat	A	4	30	20	-	50	50	I	Departamentit te edukimit
	b.Kulturë gjuhe	A	4	30	20	-	50	50	I	Gjuhë-Letërsisë
	GJITHËSEJ		4	60	40	-	100	100	I	
IV	Metodat e kërkimit shkencor									
	a.Metodat e kërkimit në shkencën e edukimit b.Seminar kërkimor (për përgatitjen e mikrotezës)	C	7	30	50	-	80	95	I	Shkencave sociale
	GJITHËSEJ		7	30	50	-	80	95		
V	Mësimdhënia dhe të nxënët në Biologji-Kimi									

	a. Metodologjia e mësimdhënies së Biologjisë dhe vlerësimi	B	6	40	20	20	80	70	II	Biokimi-Agroushqim
	b. Metodologjia e mësimdhënies së Kimisë dhe vlerësimi	B	6	40	20	20	80	70	II	Infermierisë dhe Grupit mësimor kërkimor i Biologji-Kimisë
	c. Teknika e laboratorit dhe eksperimentit në biologji.	B	3	15	-	20	35	40	II	Biokimi-Agroushqim
	d. Teknika e laboratorit dhe eksperimentit në kimi	B	3	15	-	20	35	40	II	Infermierisë dhe Grupit mësimor kërkimor i Biologji-Kimisë
	GJITHËSEJ		18	110	40	80	230	220		
VI	<i>Formim akademik për disiplina shitesë</i> Edukimi shëndetësor dhe metodologjia në edukimin shëndetësor									
	a. Edukimi shëndetësor	B	3	30	15	-	45	30	II	Infermierisë dhe Grupit mësimor kërkimor i Biologji-Kimisë
	b. Metodatat e mësimdhënies në edukimin shëndetësor	B	6	45	30	-	75	75	II	Infermierisë dhe Grupit mësimor kërkimor i Biologji-Kimisë
	GJITHËSEJ		9	75	45		120	105		
VIII	Shprehi gjuhësore dhe komunikimi									
	a. Gjuhë angleze për qëllime specifike	E	3	15	15	-	30	45	II	Gjuhëve të huaja
	b. Teknologjia e komunikimit dhe informacionit në ndihmë të mësimdhënies.	E	5	30	30	-	60	65	II	Informatikë dhe Fizikë
	GJITHËSEJ		3	45	45	-	90	110		
	GJITHËSEJ VITI I PARË		60	394	274	80	748	752		

VITI I DYTË

I	Zhvillimi profesional i mësuesit dhe etika e profesionit	C	4	20	30	-	50	50	III	Gjuhëve të huaja
II	Shëndeti mjedisor	B	3	25	13	-	38	37	III	Infermierisë dhe Grupit mësimor kërkimor i Biologji–Kimisë
	Lëndë me zgjedhje:									
III/1	Menaxhimi i arsimit dhe Legjislacioni i arsimit parauniversitar	D	3	20	10	-	30	45	III (zgjidhet nje lende)	Historisë-Gjeografisë
III/2	Teknika e metodave instrumentale te analizave kimike	D	3	20		10	30	45	III (zgjidhet nje lende)	Infermierisë dhe Grupit mësimor kërkimor i Biologji–Kimisë
IV	Praktikë shkollore e mësimdhënies	E	10	-	-	-	130	120	III	
V	Teza e diplomimit	F	10	-	-	-	125	125	III	
	GJITHËSEJ VITI I DYTË		30	65	53/43	0/10	373	377		
	GJITHËSEJ PROGRAMI		90				1121	1129		SHUMA 2250 ORË

9-14 DETYRIMET E MUNDSHME QË LIDHEN ME FREKUENTIMIN

MASTER PROFESIONAL NË “MËSUESI PËR ARSIMIN E MESEM TË LARTE NË BIOLOGJI-KIMI”

1. Hartimi i kësaj Rregulloreje është bazuar në ligjin nr. 9741, dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në udhëzimin nr. 4, dt. 22.01.2008 “Për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të Master të Nivelit të Parë dhe të Dytë”, në udhëzimin nr. 15, dt. 15.4.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë” etj.

Kjo Rregullore mësimore është bërë në përputhje me planin mësimor, duke respektuar liritë akademike, si dhe të drejtat e detyrat e personelit akademik dhe të studentëve.

Departamenti “Infermierisë dhe Grupit mësimor kërkimor i **Biologji–Kimisë**” ofron për studentët një program studimi Master Profesional me kohë të plotë.

Rregullorja specifikon aspektet organizative të programeve të studimit të ciklit të dytë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Humane të Universitetit “Fan S.Noli”, i cili ofron programin e studimit “**Master Profesional**” në “**MËSUESI PËR ARSIMIN E MESEM TË LARTE NË BIOLOGJI-KIMI**”

Përgatitja dhe zhvillimi i këtij programi studimi mbështet në udhëzimet e Ministrit të Arsimit nr.4, datë 22.1.2008, nr.15, datë 4.4.2008 dhe udhëzimin e datës 22.6.2010.

2. Programi i studimit dhe titulli përkatës

- Ky Program Studimi zhvillohet pranë **Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane, të Universitetit “Fan S.Noli” Korçë.**
- Funkcionimin organizativ të këtij Programi e realizon Komiteti Shkencor i Programit.
- Titujt i këtij Programi studimi jepen nga **Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane, të Universitetit “Fan S. Noli” Korçë.**
- Programi i studimit “Master Profesional” përfundon me titullin e diplomës: “**MASTER PROFESIONAL, “MËSUESI PËR ARSIMIN E MESEM TË LARTE NË BIOLOGJI-KIMI”**”

3. Kriteret e pranimit të studenteve në këtë program studimi

- Që studenti të regjistrohet në programin “Master Profesional” në “**MËSUESI PËR ARSIMIN E MESEM TË LARTE NË BIOLOGJI-KIMI**”
- duhet të zotërojë një Diplomë të sistemit të vjetër ose Bachelor në “**BIOLOGJI-KIMI**” (pa plotësim të njohurive formuese).
- Për të gjitha diplomat e Ciklit të Parë ose diploma të tjera, të lëshuara nga Institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë Shqipërisë (analoge me ato të lëshuara nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane, të Universitetit “Fan S.Noli”), bëhet vlerësimi rast pas rasti nga, Komisioni vlerësues i ngritur posacërisht për të vlerësuar kriteret e këtij lloji.

- Shlyerja e njohurive formuese plotësuese nga Cikli i I, bëhet gjatë semestrit të parë të programit të studimeve në “Master Profesional” sipas datave që do të caktojë dekanati në fillim të vitit akademik.
- Në rast se numri i kërkesave të paraqitura i kalon kuotat e miratuara nga Fakulteti, do të zbatohen kritere të tjera specifike:
 - a. Tipi i Diplomës së Ciklit të parë të studimeve
 - b. Njohja në nivel të lartë e gjuhës angleze, diploma përkatëse.
 - c. Mesatarja (mesatarja 5 = 0 pikë, 5.1 = 1 pikë...10 = 50 pikë)
- Pranimi i studentëve në “Master Profesional” në bëhet në muajin shtator.
- Kërkesat për pranim paraqiten pranë Sekretarisë së Fakultetit brenda datës 20 shtator. Brenda 1 jave nga afati i përfundimit të kërkesave, Komisioni vlerësues i fakultetit shqyrton kërkesat dhe jep vlerësimet përkatëse. Në rastin e paraqitjes të më shumë kërkesave sesa numri i parashikuar hyn në zbatim pikat (a, b, c).

4. Kushtet për procedurat dhe modalitetet për transferimin e studentëve

- Studentët mund të transferohen nga një universitet në tjetrin brenda të njëjtit program studimi vetëm pas përfundimit të vitit të parë.
- Komisioni vlerësues, që ngrihet në fakultet, vlerëson rast pas rasti dokumentacionin dhe formimin e studentit, për të përcaktuar nëse i duhet të shlyejë ndonjë lëndë, që ai nuk e ka zhvilluar në vitin e parë.
- Kërkesat për transferim duhet të dorëzohen brenda datës 10 të muajit shtator në sekretarinë mësimore. Vlerësimi i dokumentacionit bëhet brenda datës 15 shtator dhe njoftimi një ditë më pas.

5. Numri maksimal i krediteve që mund të njihen në programin e studimit

- Programi i studimeve “Master Profesional” në “MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTE NË BIOLOGJI-KIMI” do të zhvillohet në 1.5 vite akademik, i ndarë në 3 semestra dhe përfundon me realizimin e 90 krediteve.
- Viti akademik është i organizuar në javë mësimore, javë provimesh dhe javë praktike profesionale në shkolla dhe përgatitje për mbrojtjen e temës së Diplomës.

6. Detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin.

- Studentët janë të detyruar të frekuentojnë 80% të orëve të mësimit në auditor dhe të praktikave profesionale. Në rast të mosrespektimit të këtij detyrimi, studenti shpallet përsëritës për atë lëndë.
- Plani mësimor përfshin disiplina të shkencave të edukimit dhe të kërkimit në edukim, disiplina formuese të zgjedhura nga studentët dhe disiplina formuese që karakterizojnë përkatësinë e programit të studimit, përdorimin praktik të gjuhës angleze, aftësive komunikative, praktika profesionale dhe teza e diplomës, të cilat do të realizojnë 90 kredite apo përmbi 2250 orë pune për studentët që përfshijnë orët e planifikuara për leksione dhe seminare në auditor, orët për përgatitjen individuale të studentëve për seminarat dhe provimet, orët për kërkime në bibliotekë, si dhe orët e punës për praktikat profesionale, për hartimin e tezës së diplomës etj.

7. Format e studimit dhe të vlerësimit

- Format e studimit dhe të vlerësimit është trajtuar hollësisht në Rregulloren e studimeve të Universitetit “Fan S.Noli”.
- Forma e studimit është me **kohë të plotë**.
- Procesi i vlerësimit të studentëve është pjesë e rëndësishme e procesit mësimor që kryhet përgjatë zhvillimit të një disipline dhe finalizohet me zhvillimin e provimeve e shpalljen e përfundimeve.

a. *Vlerësimi i studentit*

- Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: **vlerësimi i vazhdueshëm** gjatë vitit për elementet e përcaktuar në programin e disiplinës a modulit dhe **vlerësimi përfundimtar**.
- Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë vitit përfaqëson 30% të vlerësimit total. Përbërësit e vlerësimit të vazhduar bëhen nga çdo pedagog në programin e disiplinës a modulit dhe pasqyrohen në rregulloren e programit të studimit.
- Në përfundim të procesit mësimor (në orët e fundit të mësimit), çdo pedagog që është përgjegjës lënde duhet t’u komunikojë studentëve në auditor:
 1. Fitimin ose jo të së drejtës për t’u futur në provimin e disiplinës (modulit) përkatëse;
 2. Rezultatin e vlerësimit të vazhdueshëm në seminare, laboratore, tema e detyra kursi apo në forma të tjera kontrolli të ushtruara gjatë semestrit, si pjesë e vlerësimit përfundimtar.

3. Rezultati i vlerësimit të vazhdueshëm merret parasysh vetëm në vlerësimin përfundimtar të studentit, në sezonin e parë të provimeve.

- Mënyrat e kontrollit të dijeve (provim) përcaktohen në programin e disiplinës a modulit

b. Llojet e provimeve

- Provimi është formë e kontrollit të dijeve që duhet të përfundojë brenda afateve të parashikuara.
- Kontrolli i dijeve mund të bëhet: a) me shkrim, b) me gojë, c) i kombinuar (me shkrim e me gojë). Departamenti përcakton nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eliminuese.
- Tezat e provimit hartohen nga titullari i disiplinës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.
- Gjatë zhvillimit të provimit (me shkrim ose me gojë) nuk lejohet ndërrimi i tezës.
- Zgjedhja e formës së provimit bëhet nga pedagogu/ët i lëndës dhe pasqyrohen në rregulloren mësimore të programit të studimit qysh në fillim të semestrit, duke ua bërë të ditur studentëve

c. Dokumentacioni i provimit

- Një kopje e tezave të provimit me gojë për çdo disiplinë ruhen në departament. Ato rinovohen herë pas herë, në varësi të ndryshimit të programit të disiplinës (modulit).
- Procesverbalet e provimit me gojë dorëzohen në sekretari brenda 2 ditëve nga data e zhvillimit të provimit.
- Procesverbalet e provimit me shkrim dorëzohen në sekretari brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të provimit

d. Afatet e përcaktuara për provimet

- Provimet dhe riprovimet në të gjitha format e studimeve zhvillohen sipas afateve të caktuara në strukturën e vitit akademik, të miratuara nga Këshilli i Fakultetit dhe të pasqyruara në grafikun e provimeve.
- Provimet dhe riprovimet zhvillohen në 4 sezone: sezoni i Dimrit (Shkurt, Mars); sezoni i Verës (Qershor, Korrik); sezoni i vjeshtës (Shtator) dhe sezoni plotësues. Në sezonin plotësues për çdo disiplinë apo modul do të ketë vetëm një datë provimi. Ato miratohen dhe shpallen nga Dekani jo më vonë se dy javë para fillimit të sezonit.

- Afatet e përcaktuara për provimet dhe riprovimet janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët, ashtu dhe nga studentët. Ndryshimi i datës së provimit bëhet vetëm me miratim të dekanit.
- Studenti nuk lejohet të hyjë për të dytën herë në provimin e një disipline, brenda të njëjtit sezon.
- Studenti paraqitet në provim me librezën e studentit. Në mungesë të saj mund të paraqitet edhe dokument tjetër identifikimi.

e. Kohëzgjatja e provimeve

- Kohëzgjatja e një provimi me gojë është jo më shumë se 30 minuta për çdo student, ndërsa provimi me shkrim zgjat jo më pak se 2 orë.
- Pas dhënies së tezës në provimin me shkrim, nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjerë të grupit apo kursit përkatës.
- Anëtarët e komisionit të provimit të disiplinës mbikqyrin zhvillimin korrekt të provimit gjatë gjithë kohës, nga dhënia e tezës deri në përfundimin e provimit.

f. Ankimimi për provimin

- Studenti ka të drejtë të ankohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose për vlerësim të pamerituar. Ankesa bëhet me shkrim *brenda ditës së marrjes së rezultatit për provimin me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë për provimin me shkrim, nga data e dhënies së tij* dhe i drejtohet dekanit të fakultetit. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës brenda dy ditëve. Ky vendim është i formës së prerë.
- Në rast se vërtetohen praktika që bien ndesh me dispozitat e kësaj rregulloreje, atëhere, me propozimin e Përgjegjës të Departamentit, dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe për rihënien e provimit brenda ditës ose të nesërmen, pas përfundimit të tij.

g. Sistemi i vlerësimit

- Studenti që për çfarëdo arsye nuk paraqitet në provimin e një disipline, humbet të drejtën e provimit dhe konsiderohet mbetës për atë disiplinë në atë sezon.
- Gjithashtu studentit vlerësohet mbetës, kur:
 - a. Nuk është i përgatitur;
 - b. Tërhiqet nga provimi;
 - c. Kopjon ose mashtron me mjete ndihmëse jo të lejueshme (në këtë rast ai përjashtohet nga provimi).

d. Pengon zhvillimin e rregullt të provimit/kolokiumit (në këtë rast ai përjashtohet nga provimi).

e. Studenti nuk lejohet të mbrojë diplomën, nëqoftëse nuk ka shlyer të gjitha detyrimet e vitit të fundit si dhe ato të mbartura.

- Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash. Nota kaluese më e ulët është nota pesë.
- Në format e kontrollit me shkrim përdoret edhe sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht kthehet në notë. Vlerësimi i vazhduar zë 30% të vlerësimit përfundimtar të studentit. Vlerësimi përfundimtar në bazë të totalit të pikëve të provimit dhe vlerësimit të vazhduar do jetë:

deri në 39 pikë	Nota 4
40-50	Nota 5 (minimumi i pikeve 40)
51-60	Nota 6
61-70	Nota 7
71-80	Nota 8
81-90	Nota 9
Mbi 91	Nota 10 (maksimumi i pikeve 100)

- Për vlerësimin përfundimtar të studentit mblidhen pikët e vlerësimit të vazhduar me vlerësimin në provim.

8. Mbrojtja e Temës së Diplomës

- Në përfundim të Programit të studimit “Master Profesional” diplomantët realizojnë një provë finale në formën e mbrojtjes së tezës së diplomës, që vërteton aftësimin profesional dhe shkencor të studentëve.
- Mbrojtja e Tezës së Diplomës bëhet publike dhe konsiston në një punim me shkrim. Ky punim parakupton të përbëjë rezultatin e një studimi të thelluar të literaturës shkencore dhe vëzhgimi në praktikë, reflektimin e përvojës vetjake të fituar gjatë fomimit teorik dhe praktik dhe dhënien e përfundimeve dhe të sugjerimeve mbi argumentin e përzgjedhur nga vetë studentit.

Tipologjitë e temave:

A. Temë metodike në mësimdhënien e disiplineve të Biologji-Kimisë për mosha dhe klasa të ndryshme.

B. Temë në fushën e kërkimit në lidhje me karakterin zbatues të disiplineve të Biologji-Kimisë.

C. Temë teorike krahasuese në fushën e Mësimdhënies dhe të përvetësimit të disiplineve të Biologji-Kimisë.

D. Temë kërkimore në fushën e Edukimit me të cilën lidhet disiplina e Biologji-Kimisë.

Kriteret e hartimit të punimit për mbrojtjen e diplomës:

- Punimi i diplomës në studimet master paraqet punën individuale të studentit i cili me anë të tij vërteton se aftësitë teorike të arritura gjatë periudhës së tij të studimeve, mund të shfrytëzohen me kujdes për zgjidhjen e problemeve praktike në fushën shkencore të programit mësimor.
- Me anë të punimit të diplomës studenti tregon se ka përvetësuar temën e dhënë, e ka punuar atë me metodën që i përgjigjet punimit, njeh lëndën, terminologjinë dhe literaturën e përdorur profesionale dhe është i aftë ta citojë atë në mënyrë të rregullt.
- Në punimin e diplomës duhet të dalë në dukje aftësia e të menduarit dhe e punës së pavarur të studentit, respektivisht aftësia për të nxjerrë përfundime dhe për të bërë propozime për zgjidhjen e problemit të caktuar.
- Pjesa e mikrotezës për diplomën “Master” duhet të ketë si rregull jo më pak se 40 dhe jo më shumë se 60 faqe kompjuterike të formatit A4. Referencat, shënimet në fund të faqes, shtojcat, tabelat, diagramet nuk përfshihen në këtë përlllogaritje. Numri maksimal i karaktereve në një faqe për punimin e mikrotezës është maksimumi 2000.
- Vendi që zënë elementet e punimit:
 - Hyrja 4-6 faqe
 - Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes 7-8 faqe
 - Trajtimi i çështjes dhe argumentimi i problematikës 20 – 30 faqe
 - Përfundime 4 -6 faqe
 - Bibliografia
- Të gjitha temat e diplomës së programit “Master Profesional” bëhen nën drejtimin e një pedagogu si udhëheqës i temës.
- Të gjithë pedagogëve, me grada apo titull, u lind e drejta të bëjnë udhëheqje të temave të diplomës për Programin “Master Profesional”
- Gjithashtu, temat e diplomave kanë edhe një pedagog oponent, i cili paraqet me shkrim vlerësimin e tij.
- Përzgjedhja e temës bëhet nga studenti në bashkëpunim me udhëheqësin brenda muajit dhjetor të semestrit të parë të vitit të parë, të cilët firmosin një formular.
- Studenti, nëse e sheh të arsyeshme, mund të kërkojë ndërrimin e udhëheqësit brenda afatit të përcaktuar më lart. Platforma me bibliografinë përkatëse dorëzohen përfundimisht pranë Sekretarisë.

- Për t'u pranuar në mbrojtjen e temës, studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit “Master Profesional”.
- Punimi dorëzohet në tre kopje dy javë përpara datës së mbrojtjes. Studentët, të cilët nuk respektojnë këto afate ose nuk kanë marrë 90 kredite, nuk mund të bëjnë mbrojtjen e temës në sesionin e dimrit. Vetëm pasi të kenë shlyer detyrimet e mësipërme dhe të kenë dorëzuar punimin dy javë përpara datës së mbrojtjes, studentëve u lind e drejta të bëjnë mbrojtjen e temës në sesionin e verës.
- Komisioni i vlerësimit të temave të diplomave përbëhet nga 3 (tre) pedagogë, prej të cilëve njëri është oponent dhe dy të tjerë duhet të jenë të fushës përkatëse. Komisioni caktohet nga Dekani i Fakultetit. Për vlerësimin e temës mbahen parasysh tre kritere:
 - a) përmbajtja origjinale, dobia e punimit dhe zbatimi praktik;
 - b) mënyra e paraqitjes me gojë dhe
 - c) mesatarja e vitit të studimeve të Programit
- Studentët që fitojnë në Programin e studimit paguajnë tarifën e përcaktuar të shkollimit me fillimin e vitit akademik.

9. Infrastruktura në dispozicion të programit.

- *Auditorë* Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane ka në dispozicion 1 auditor me kapacitet rreth 140 vende, 2 auditorë me kapacitet 80 vende 10 klasa për zhvillimin e orëve të seminareve me kapacitet 20- 40 vënde, Internet broadband 24 orë në gjitha ambientet e fakultetit. Universiteti i “Fan S. Noli” i Korçës ka marrë në pronësi edhe një, Korçë dhe rreth 10 klasa me kapacitet 30 vënde do të vihen në dispozicion të programeve master.
- *Laboratorë* Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane ka 2 laboratorë me infrastrukture bashkëkohore pajisje moderne reagente të bollshëm gjë që bën të mundur realizimin e programit mësimor si dhe programin studimor për të kryer punë kërkimore shkencore dhe eksperimentale të studenteve për tezat e diplomave.
 1. Laboratori i biologjisë me rreth 30 vende. I pajisur me pajisje bashkëkohore si: mikroskop me fluoreshencë, mikroskopë optikë, centrifugë, inkubator, banjo mari, autoklavë, peshore elektronike, përzierës elektromagnetik, mikrotom etj. Gjithashtu është i paisur me makete, atlase, reagent, mjete për realizimin e planit mësimor dhe punës kërkimore.
 2. Laboratori i kimisë me rreth 30 vende. I pajisur me pajisje bashkëkohor si: polarimetër, pH metër, centrifuge, banjo mari, distilator, peshore analitike, elektornike, teknike, fotoelektrokolorimetër (FEK), spektrofotometër,

flamfotometër, autoklavë, termostat, furrë Mufle, gas analizator, kapë, byreta dixhitale, viskozimetër, etj. Gjithashtu është i paisur me reagentë të bollshëm, qelqurina, për realizimin 100% të programit mësimor si dhe për të kryer punë kërkimore për për tezat e diplomave.

3. Dy laboratorë informatike me 30 kompjutera secili.

- Në dispozicion të programeve master dhe Departamenti Biokimi-Agroushqim i F.B. të Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës ka 2 laboratorë me infrastrukture bashkëkohore pajisje moderne.
 1. Laboratori i mikrobiologjisë me rreth 30 vende. Ka nje experience 44 vjecare. I rinovuar me pajisje bashkekohore elektronike, reagente të bollshëm, qelqurina per realizimin 100% te programit mësimor si dhe për të kryer punë kërkimore per për tezat e diplomave
 2. Laboratori i metodave të analizave instrumentale me rreth 30 vende. I pajisur me pajisje modern si polarimetra, fotometrat me filtra (FEK), spektrofotometrat (SF UV-VIS), fotometra me flakë, pH-metra, gaz kromatograf, kromatograf i lëngët me performancë të lartë (HPLC), elektroforezë, te gjitha paisjet ndimëse per zhvillimin e puneve, reagente të bollshëm, qelqurina për realizimin 100% të programit mësimor si dhe për të kryer punë kërkimore për tezat e diplomave.
- *Biblioteka.* **Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane** ka 1 bibliotekë në dispozicion të të gjithë studentëve të fakultetit, e organizuar sipas një sistemi bashkëkohor kërkimi dhe studimi. Kjo bibliotekë garanton mbështetjen e programit të studimit me një informacion të përditësuar të nivelit të lartë.
- *Sekretaria Mësimore.* **Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane** disponon infrastrukturë bashkëkohore pune.
- *Departamenti i Infermierisë dhe Grupi mësimor kërkimor i Biologji–Kimisë* disponon infrastrukturë bashkëkohore pune.